REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA CËRRIK

Nr._____Prot. Cërrik, më 08.07.2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data: 08.07.2021]

Për: *[Viola Green,* **Tirane TIRANE Bulevardi Bajram Curri , Qendra ETC, Kati 13/1***]*

Procedura e prokurimit: "**Procedure e hapur (prokurim me mjete elektronike)"**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-85499-02-01-2021**
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *"**Shërbimi i pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të qytetit Cërrik dhe Njësive Administrative** "*

Publikime të mëparshme *(ska):* Buletini i Njoftimeve Publike *[08.02.2021] [17]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit**: çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme □

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. ***OE " Alko Impex" sh.p.k*** **K91326028I**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera **21915904 (***njezete e nje milion e nenteqind e pesembedhjete mije e nenteqind e kater***)** leke pa tvsh

*(me numra dhe fjalë*

2. ***OE " Rej" sh.p.k*** **J93711608Q**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera **21769893 (** *njezete e nje milion e shtateqind e gjashtedhjete e nentemije e teteqind e nentedhjete e tre* **)** *(me numra dhe fjalë)*

3. ***OE " Viola Green sh.p.k*** **L51928004K**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera **24885393 (** *njezete e kater mije e teteqind e tetedhjete e pese mije e treqind e nentedhjete e tre* **)** leke pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**Alko Impex sh.p.k"**

**Rej sh.p.k**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**Alko Impex sh.p.k**
Ne ambjentet e Bashkise Cerrik ne date 21.05.2021 ka mberritur shkresa me date 21.05.2021 me Nr.280 prot; me lenden : ***Terheqje nga procedura e prokurimit me objekt" Shërbimi i pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të qytetit Cërrik dhe Njësive Administrative"nga Operatori ekonomik Alko impex general Construction" per arsye objektive.***
OE nuk ka pritur perfundimin e vleresimit pa nje vendim perfundimtar per oferten e paraqitur, pasi me ane te shkreses hyrese ne institucion nr. 280 prot date 21.05.2021 me numer hyres ne institucion, me lende "Kerkese per terheqje ....", OE Alko Impex General Construction ka paraqitur kerkese per te mos marre ne shqyrtim oferten e paraqitur duke u terhequr nga pjesemarrja ne kete procedure. Nga shqyrtimi i kerkeses prane Autoritetit Kontraktor, me ane se ciles operatori ekonomik kerkon te terhiqet nga procedura e prokurimit objekt vleresimi, Komisioni veren se nje situate e tille nuk eshte e rregulluar nga ligji nr.9643,

date 20.11.2006 ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar. Duke qene se kjo situate nuk rregullohet nga ligji per prokurimin publik, i ndryshuar, Komisioni i drejtohet ligjit nr.44/2015 ”Kodi i procedurave Administrative i republikes se shqipersise”, i cili ne nenin 94 ”Terheqja e kerkeses apo braktisja e procedures”, pika 1, parashikon se: ”Si rregull, ne proceduren administrative te nisur me kerkese, organi publik deklaron perfundimin e saj pa nje vendim perfundimtar per ceshtjen, nese pala qe ka paraqitur kerkesen e terheq ate”. Komisioni gjykon se, operatori ekonomik eshte ne te drejten e tij te kerkoje te heqe dore nga procedura objekt vleresimi duke argumentuar veprimet e kryera per kerkesen ne procesverbalin perkates pjese e procedures, qe sjell si pasoje shqyrtimin/vleresimin e ofertes se tij nga AK. Heqja dore nga pjesemarrja ne procedure nga operatoret ekonomik sjell si rrjedhoje perfundimin e vleresimit pa nje vendim perfundimtar per oferten e paraqitur ne kete procedure.

**Rej sh.p.k.**

1. Ne piken 2 germa e; e kerkesave te vecanta per kualifikim percaktohet *e:vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*
   Nga verifikimi i Ekstraktit te QKB si dhe bukonstatohet se nder te tjera OE kryen aktivitet ne:

a. Elbasan Prrenjas PRRENJAS Lagjja nr 2, rruga Nacionale, **objekt privat** me nr 16 Prrenjas

a. Korce Udenisht UDENISHT Korçe-Pogradec,fshati Udenisht,**ambjent** me nr pasurie 203/1, zona kadastrale 3665

per te cilat nuk ka sjelle vertetim per shlyerjen e energjise. FSHU evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë: 1.Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara). 2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private. 3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përvec rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira. Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, FSHU i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimt bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Ne QKB konstatohen selite dytesore ne objecte pa informuar ne kete rast nese ai furnizohet apo jo me energji ne keto ndertesa apo eshte ne kushtet e shmangjes se lidhjes se kontrates apo eshte me qera dhe qeradhenesi paguan si familjar. Persa me lart konstatojme se OE nuk ka paraqitur vertetim te plote te pageses se detyrimeve te maturuara te energjise elektrike.

2. Ne piken 6 germa a te kerkesave te vecanta per kualifikim percaktohet: *6.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat e meposhtme: a.**ISO 9001 – 2015** për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme)*
   Per te plotesuar kete kerkese OE ka paraqitur ISO 9001-2015 me nr. 1710AL251Q ne te cilen percaktohet se certifikata eshte e vlefshme vetem me kushtin e mbikqyerjes vjetore, kusht i cili ka skaduar sipas konstatimit ne Nentor 2020 (sipas percaktimit ne ISO- Viza vjetore deri ne Nentor 2020). Persa me lart ISO 9001-2015 e paraqitur nuk eshte e vlefshme ne kundershtim me kerkesat per kualifikim.

3. Ne piken 8 germa c te kerkesave te vecanta per kualifikim percaktohet: *8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme: c.Makina për Lagien e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për Lagien e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë jo më pak se 1 **(një) copë**;* ne kerkesat per kualifikim gjithashtu percaktohet se: *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) sëbashku me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion të mjetit.Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).*
   Ne konktraten e paraqitur mes OE Rej dhe Gjikuria percaktohet se ajo eshte nje kontrate qeraje por konstatohet se nuk eshte lidhur ne prani te noterit. Eshte e vertete qe ne kerkesat per kualifikim percaktohet se: *Autoriteti kontraktor do te pranoje disponueshmerine e mjeteve dhe*

*ne forma te tjera qe njeh legjislacioni ne fuqi duke mos u kufizuar ne disponueshmerine e mjeteve ne pronesi apo me qera.* Por kur OE deklaron nje kontrate qeraje ajo detyrimisht duhet te plotesoje kushtet e legjislacionit ne fuqi per te qene e vlefshme. Persa me lart OE nuk e ploteson kerkesen e mesiperme.

4. Në piken 8 germa d të kerkesave te vecanta per kualifikim percaktohet: *8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme: d. Mjete teknologjike rezervë: Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës* ***8-12 ton*** *raport kompaktimi 1:4 - 1:6* ***2 (dy) copë;***

   Konstatohet se per nje nga mjetet nuk eshte paraqitur dokument per certifikaten e kontrollit teknik apo vertetim per shtyrjen e vlefshmerise se kontrollit teknik e pikerisht per mjetin AB753CG. Persa me lart OE nuk e ploteson kerkesen e mesiperme.

5. Në piken 8 germa d te kerkesave te vecanta per kualifikim percaktohet: *8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme: l: Si mjete dhe paisje për kryerjen e shërbimit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon jo më pak se 87 konenierë me volum 1.1, shoqëruar me akt pronësie- akt zhdoganimi, faturë tatimore blerje/ose me qira. Në rast se paisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme për gjatë gjithë periudhës së kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë të qiradhënësit. Kontenierët duhet të përmbushin standarded EN 840 dhe RAL ose SSH ose ekuivalent vërtetuar kjo e fundit me certifikatë cilësie. Për paisjet e mësiëprme të të dorëzohet edhe katalogët përkatës.*

   Konstatohet se per te provuar paraqitjen e cilesise per EN 840 dhe RAL ose SSH ose ekuivalent dhe kataloget perkates OE ka paraqitur dy dokumenta te cilet jane ne gjuhe te huaj. Ne DST shtojca 8 percatohet se: *Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.* Persa me lart OE nuk e ploteson kerkesen e mesiperme.

6. Në piken 9 te kerkesave per kualifikim percaktohet: *Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose me qera një pikë brenda territorit të Bashkisë Cerrik jo më pak se 250 m2, të nevojshme për larjen, dezinfektimin e kontenierëve, mirëmbajtjen e tyre sipas termave të referencës, si edhe larjen e mjeteve dhe mirëmbajtjen e nëvojshme për kryerjen e shërbimit. Gjithashtu operatori duhet të dëshmojë se disponon mjetet e nevojshme për kryerjen e shërbimit të larjes dhe dizinfektimit të kontenierëve si: depozitë uji Pompë lavazhi shoqëruar me akt pronësie- akt zhdoganimi, faturë tatimore blerje/ose me qira. Në rast se paisjet disponohen me qira operatori ekonomik duhet të dorëzojë kontratën e qirasë të vlefshme për gjatë gjithë periudhës së kontratës shoqëruar me aktin e pronësisë të qiradhënësit.*

   Për plotesimin e kerkeses se mesiperme konstatohet se OE ka paraqitur nje kontrate qeraje jo noteriale si dhe vertetimin e pronesise bashkengjitur te pacertifikuar nga noteri. Ne baze te legjislacionit ne fuqi qe nje kontrat qeraje per pasuri te paluajtshme te konsiderohet e vlefshme ajo duhet te hartohet ne prani te noterit. Persa me lart OE nuk e ploteson kerkesen e mesiperme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[**Viola Green,*** **Tirane TIRANE Bulevardi Bajram Curri , Qendra ETC, Kati 13/1***]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **24885393 (** *njezete e kater mije e teteqind e tetedhjete e pese mije e treqind e nentedhjete e tre* **)** pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[**Bashkisë Cërrik,Lagja Nr.2 Ruga "Gjimnazistet 1962"**]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 24 oreve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.06.2021

Ankesa: ka ose jo : ska

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ___________________________

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**
**OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**
**Tomorr Zaimaj**